# DËSHMI ARKIVI

**A-474556**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pas 27 vitesh, identifikohen me ADN tri viktima të “Grupit të Intelektualëve të Mitrovicës |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/pas-27-vitesh-identifikohen-me-adn-tri-viktima-te-grupit-te-intelektualeve-te-mitrovices/1029990/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 18:21:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 18:17:55 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7b95fdbda4bbd81d6a83aa46f0decaddb4c15fedb7df117ca61fd22d27fa9392` |
| TEKSTI | `515320f3aea5300ec45aa4550471d96924ff746b838a69bc7d00df6f0f32987f` |
| PAMJA | `484f74608616b863ab46556e83a5c22694df300d09ed602582c249b4e8222680` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8f9482d4272f76d19f72aff78e39923d1c0a4bb6c960867e7a06d6b140b2487c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8f9482d4272f76d19f72aff78e39923d1c0a4bb6c960867e7a06d6b140b2487c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Pas 27 vitesh, identifikohen me ADN tri viktima të “Grupit të Intelektualëve të Mitrovicës



Pas më shumë se 27 vitesh pritjeje dhe pasigurie, laboratori i Hagës ka konfirmuar zyrtarisht tri viktimat e para të identifikuara përmes analizave të ADN-së nga i ashtuquajturi “Grupi i Intelektualëve të Mitrovicës”.

Identifikimet u mundësuan pas një muaji operacionesh intensive të gërmimit në tri varreza masive në Zubin Potok. Në këto lokacione, gjatë prillit të vitit 1999, forcat serbe ekzekutuan dhe fshehën trupat e 23 civilëve shqiptarë, mes tyre mjekë, profesorë dhe veprimtarë të njohur. Ndërkohë që analizat për pjesën tjetër të grupit vijojnë, Komisioni Qeveritar po kërkon hapjen e arkivave të luftës dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

Pas 27 vitesh, gërmimet në fshatrat Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut kanë nxjerrë në dritë mbetjet mortore që dyshohet se u përkasin 23 civilëve të njohur si “Grupi i Intelektualëve” nga Mitrovica. Zhvarrimi është përmbyllur zyrtarisht, ndërsa raportet e para të ardhura nga Haga kanë bërë të mundur identifikimin e tri viktimave. Mostrat e tjera mbeten ende nën shqyrtim.

Kushtrim Gara, nga Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur, tha se institucionet kosovare kanë marrë tri raportet e para të ADN-së dhe po bashkëpunojnë vazhdimisht me ekspertët mjekoligjorë të Komisionit Ndërkombëtar për pranimin dhe përshpejtimin e procedurave për mostrat e tjera të dërguara nga lokacionet e varreve masive në Kalludër dhe Jabukë. Sipas tij, sapo të mbërrijnë rezultatet e reja, familjarët e viktimave do të njoftohen, siç ndodhi edhe me tri identifikimet e para.

“Grupi i Intelektualëve” përbëhej nga kirurgë, mjekë, profesorë dhe aktivistë të çështjes kombëtare. Ata po largoheshin në mënyrë të organizuar drejt Malit të Zi për t’i shpëtuar përndjekjes, por u ndaluan në zonën e Zubin Potokut dhe u ekzekutuan. Më pas, trupat e tyre u vendosën në varreza masive me synimin për të fshehur gjurmët e krimit.

Mes tri viktimave të identifikuara ndodhet edhe veprimtari i njohur Idriz Rrecaj. Megjithatë, puna forenzike nuk ka

të fundit/


Pas 27 vitesh, identifikohen me ADN tri viktima të “Grupit t…


E rëndë në Fier/ Banesa u përfshi nga flakët, çatia i ra në…


Ahmeti: Çlirimtarët nuk mund të dënohen në emër të shqiptarëve


Kosova ngushton diferencën, Edon Zhegrova shënon ng…


Bekteshi reagon ashpër ndaj Ramës: Tërbimi në Nju Jork dhe përdori…


Marshimi drejt Kryeministrisë: Edi Rama gjithë Shqipëri…


Incident i ri me agjentët e OpenAI: nën hetim anashkalimi i filtrave …

Aleanca për Media Etike — ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

përfunduar, pasi analizat për mbetjet e tjera vazhdojnë. Krahas identifikimit të viktimave, mbetet e domosdoshme edhe përcaktimi i përgjegjësve dhe vënia e tyre para drejtësisë.

Gara theksoi se familjet e personave të zhdukur kanë pritur për një kohë të gjatë dhe se drejtësia nuk mund ta largojë dhimbjen, por mund të sjellë ngushëllim dhe të tregojë se vuajtja e tyre nuk është harruar. Ai nënvizoi se zbardhja e fatit të të zhdukurve me dhunë dhe ndëshkimi i përgjegjësve për krimet me përmasa gjenocidale përbëjnë detyrime të vazhdueshme institucionale, në mënyrë që të respektohet e drejta e familjeve për të mësuar të vërtetën dhe për të marrë drejtësi.

Përveç hetimeve forenzike, të gjitha provat dhe dëshmitë materiale të mbledhura në varrezat masive të veriut po i dorëzohen zyrtarisht Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Luftës.

Institucionet e Kosovës kanë përsëritur kërkesën ndaj komunitetit ndërkombëtar që të ushtrojë trysni mbi Beogradin për hapjen e arkivave ushtarake të vitit 1999. Këto dokumente vlerësohen si vendimtare për zbardhjen e plotë të masakrës.

Shtuar më 27.09.2026 20:17

Tags: fat , qeveri , shtet , zbardhja , zhdukur


Kurti zhvillon takim me Hamzën para seancës së Kuvendit


Bekteshi reagon ashpër ndaj Ramës: Tërbimi në Nju Jork dhe përdorimi i…


Vuçeviq reagon pas arrestimit të 9 serbëve: Serbia nuk do të heshtë


Tifo-grupet e Kosovës protestojnë në Prishtinë kundër vendimit të Hagës


Ymeri: Deklaratat e PDK-së dhe VV-së për Hagën pritet të votohen nesër


Nagavci: Drejtësia mund të vonojë, por kërkimi për të nuk duhet të ndalet pas…


Plisat" dhe tifozët e tjerë protestojnë në Prishtinë kundër aktgjykimit në Hagë


Forca të shtuara policore në Prishtinë para protestës së tifo-grupeve

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.